LIGJ
Nr. 50/2016

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT TË KUVAJTIT PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK ARAB PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT "REHABILITIMI I RRUGËS SË LUMIT TË VLORËS"

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Kuvajtit për Zhvillimin Ekonomik Arab për financimin e projektit "Rehabilitimi i rrugës së lumit të Vlorës", sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji dhe pjesëve përbërëse të tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 5.5.2016

Shpallur me dekretin nr. 9601, datë 16.5.2016, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

ORIGJINALI: ARABISHT
HUAJA NR. .....

MARRËVESHJE HUAJE

PROJEKTI I REHABILITIMIT TË RRUGËS SË LUMIT TË VLORËS
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT TË KUVAJTIT PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK ARAB

DATË: 2015

Marrëveshje, datë --------- ndërmjet Republikës së Shqipërisë (më poshtë i referuar si Huamarrësi) dhe Fondit Kuvajtian për Zhvillimin Ekonomik Arab (në vijim i referuar si Fondi).

Kur Huamarrësi ka kërkuar Fondin për të ndihmuar në financimin e Projektit të Rehabilitimit të Rrugës së lumit të Vlorës të përshkruar në shtojcën 2 të kësaj Marrëveshje (në vijim i referuar si Projekti), duke siguruar një kredi (në tekstin në vijim "Kredia");

Kur projekti do të zbatohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit të Huamarrësit (në vijim i referuar si "FSHZH", nëpërmjet stafit të tij aktual dhe personelit, ndërsa operimi dhe mirëmbajtja e projektit do të ndërmerren nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës nëpërmjet Auto-ritetit Rrugor Shqiptar (në vijim i referuar si "ARSH");

Kur Huamarrësi ka marrë përsipër të sigurojë të gjitha shumat, përveç kredisë, qoftë në monedhë të huaj apo monedhën vendase, të cilat janë të nevojshme për ekzekutimin e Projektit, si dhe shuma shtesë qoftë në monedhë të huaj apo monedhën vendase, si rezultat i ndonjë rritjeje në vlerësimet e kostos së Projektit;

Kur qëllimi i Fondit është të asistojë vendet arabe dhe vendet e tjera në zhvillim për zhvillimin e ekonomive të tyre dhe për t'i pajisur ato me kredi të nevojshme për zbatimin e projekteve dhe programeve të tyre të zhvillimit; dhe

Kur Fondi është i bindur për rëndësinë dhe përfitimet e Projektit për të kontribuar në zhvillimin e ekonomisë së Huamarrësit; dhe

Kur Fondi ka rënë dakord në bazë, ndër të tjera, për sa më sipër, për të siguruar kredi për Huamarrësin, sipas termave dhe kushteve të parashtruar në këtë Marrëveshje.

Si rrjedhojë, palët bien dakord si më poshtë:

Neni I

Kredia; interesi dhe tarifa të tjera; shlyerja; vendi i pagesës

Seksioni 1.01. Fondi bie dakord t'i japë Huamarrësit, sipas termave dhe kushteve të përcaktuar në këtë Marrëveshje ose të përmendur këtu, një shumë ekuivalente me dymbëdhjetë milionë dinarë kuvajtianë (K.D. 12.000.000/-).

Seksioni 1.02. Huamarrësi do të paguajë interes në normën prej dy për qind (2.0%) në vit mbi shumën e principalit të Kredisë të tërhequr dhe të papaguar herë pas here. Interesi do të akumulohet nga datat përkatëse në të cilat do të tërhiqen shumat.

Seksioni 1.03. Një pagesë shtesë prej gjysmë për qind e një përqindëshit (1/2 e 1%) në vit mbi shumat e tërhequra nga huaja dhe të papaguara herë pas here do të paguhet për të përmbushur shpenzimet administrative dhe shpenzimet e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 1.04. Në rast se Fondi, në pajtim me seksionin 3.02 të kësaj Marrëveshjeje, hyn në një angazhim të veçantë të parevokueshëm me kërkesë të Huamarrësit, një pagesë për një angazhim të tillë të veçantë do të paguhet nga Huamarrësi në normën e një gjysmë për qind të një përqindëshit (1/2 e 1%) në vit mbi shumën e principalit të çdo angazhimi të tillë të veçantë të papaguar herë pas here.

Seksioni 1.05. Interesi dhe detyrimet e tjera do të llogariten mbi bazën e një viti 360-ditor nga dymbëdhjetë muaj 30-ditorë për çdo periudhë më pak se gjysma e plotë e një viti.

Seksioni 1.06. Huamarrësi do të shlyejë principalin e huas në pajtim me dispozitat për amortizimin e huas të përcaktuar në shtojcën 1 të kësaj Marrëveshje.

Seksioni 1.07. Interesi dhe detyrimet e tjera do të jenë të pagueshme çdo gjashtë muaj, më 1 maj dhe 1 nëntor, çdo vit ose një ditë para, nëse një datë e tillë bie në ditët e festave zyrtare.

Seksioni 1.08. Huamarrësi ka të drejtë, kundrejt pagesës së të gjithë interesit të llogaritur dhe të gjitha tarifat e tjera dhe me jo më pak se një njoftim 45-ditor për Fondin, për ta shlyer para maturimit: a) të gjithë shumën e principalit të huas të papaguar në atë kohë; ose b) të gjithë shumën e principalit të një ose më shumë maturimeve, me kusht që pas një parapagimi të tillë, nuk do të jetë e papaguar ndonjë pjesë e huas që maturohet pasi pjesa të jetë parapaguar.

Seksioni 1.09. Principali dhe interesi dhe tarifat e tjera mbi Kredinë do të paguhen në Kuvajt ose në vende të tilla të tjera që Fondi do të kërkojë në mënyrë të arsyeshme

Neni II

Dispozitat e valutës

Seksioni 2.01. Të gjitha llogaritë e transa-ksioneve financiare të kryera në zbatim të kësaj Marrëveshje dhe të gjitha shumat që bëhen të pagueshme sipas saj do të jenë të pagueshme në dinarë kuvajtianë.

Seksioni 2.02. Fondi do të blejë, me kërkesë të dhe duke vepruar si agjent për Huamarrësin, monedha të tilla që mund të kërkohen për pagesën e kostos së mallrave që do të financohen nga huaja sipas kësaj Marrëveshje ose për rimbursimin e kostos së tillë në monedhën në të cilën është kryer në fakt. Shuma, e cila do të konsiderohet se është tërhequr nga huaja në çdo rast të tillë, do të jetë e barabartë me shumën në dinarë kuvajtianë, të nevojshme për blerjen e shumës përkatëse të valutës së huaj.

Seksioni 2.03. Kur shlyerja e principalit ose pagesa e interesit dhe detyrimeve të tjera mbi huan është duke u kryer, Fondi me kërkesë të dhe duke vepruar si agjent për Huamarrësin, mund të blejë shumën e dinarëve kuvajtianë të kërkuar për shlyerjen ose pagesën e tillë, sipas rastit, kundrejt pagesës nga Huamarrësi të shumës së kërkuar për blerje të tillë në monedhën ose monedhat, siç mund të jetë e pranueshme herë pas here për Fondin.

Çdo pagesë për Fondin e kërkuar sipas kësaj Marrëveshjeje nuk do të konsiderohet se është kryer përveç kur dhe deri në masën që dinarët kuvajtianë të jenë marrë në fakt nga Fondi.

Seksioni 2.04. Kurdoherë që do të jetë e nevojshme për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje për të përcaktuar vlerën e një monedhe kundrejt një tjetre, vlera të tilla do të përcaktohen në mënyrë të arsyeshme nga Fondi.

Neni III

Tërheqja dhe përdorimi i fondeve të Huas

Seksioni 3.01. Huamarrësi ka të drejtë të tërheqë nga huaja shumat e shpenzuara ose që do të shpenzohen për Projektin në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

Përveç rasteve kur Fondi mund të bjerë dakord ndryshe, asnjë shumë nuk do të tërhiqet nga huaja për llogari të shpenzimeve brenda kategorive të Projektit të përshkruara në shtojcën 2 të ndodhura para 1 janarit 2016 të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 3.02. Me kërkesë të Huamarrësit dhe sipas afateve dhe kushteve të tilla, siç do të bihet dakord ndërmjet Huamarrësit dhe Fondit, Fondi mund të hyjë në angazhime të veçanta të pakthyeshme me shkrim për të paguar shuma për Huamarrësin ose të tjera në lidhje me koston e mallrave që do të financohen sipas kësaj Marrëveshjeje, pavarësisht çdo anulimi të mëvonshëm të huas ose pezullimin e së drejtës së Huamarrësit për të kryer tërheqje nga huaja.

Seksioni 3.03. Kur Huamarrësi do të dëshirojë të tërheqë ndonjë shumë nga huaja ose t'i kërkojë Fondit për të hyrë në një angazhim të veçantë të pakthyeshëm në pajtim me seksionin 3.02, Huamarrësi, nëpërmjet FSHZH-së, do t'i paraqesë Fondit një kërkesë me shkrim në formë të tillë dhe që përmban deklarata të tilla, marrëveshje dhe dokumente të tjera që Fondi do të kërkojë në mënyrë të arsyeshme. Aplikimet për tërheqje, me dokumentacionin e nevojshëm në vijim të këtij seksioni, me kusht që përveç siç Huamarrësi dhe Fondi do të bien dakord ndryshe, do të kryhen nëpërmjet FSHZH-së menjëherë, në lidhje me shpenzimet për Projektin.

Seksioni 3.04. Huamarrësi, nëpërmjet FSHZH-së, do t'i japë Fondit dokumente dhe prova të tjera në mbështetje të kërkesës për tërheqje, siç Fondi do të kërkojë në mënyrë të arsyeshme, qoftë para ose pasi Fondi do të ketë lejuar ndonjë tërheqje të kërkuar në aplikim.

Seksioni 3.05. Çdo kërkesë për tërheqje dhe dokumentet shoqëruese dhe prova të tjera duhet të jenë të mjaftueshme në formë dhe përmbajtje për të bindur Fondin që Huamarrësi ka të drejtë të tërheqë nga huaja shumën e zbatuar për të dhe që shuma për t'u tërhequr nga huaja duhet të përdoret vetëm për qëllimet e përcaktuara në këtë Marrëveshje.

Seksioni 3.06. Huamarrësi, nëpërmjet FSHZH-së, do të përdorë të ardhurat e Huas, ekskluzivisht për financimin e kostove të arsyeshme të mallrave të nevojshme për kryerjen e Projektit, të përshkruar në shtojcën 2 të kësaj Marrëveshjeje. Mallrat specifike që do të financohen nga të ardhurat e huas dhe metodat dhe procedurat për prokurimin e këtyre mallrave do të përcaktohen si në shtojcën 3 të kësaj Marrëveshjeje dhe shtojcën e saj dhe, pa cenuar asgjë të shprehur në shtojcën 3 të përmendur, kjo shtojcë do të jetë objekt i modifikimit me marrëveshje ndërmjet Huamarrësit dhe Fondit, sipas nevojave të Projektit dhe kërkesave të zbatimit të tij.

Seksioni 3.07. Huamarrësi, nëpërmjet FSHZH-së, do të marrë masa që të gjitha mallrat e financuara nga shumat e huas të përdoren ekskluzivisht për realizimin e Projektit.

Seksioni 3.08. Pagesa nga Fondi i shumave, të cilën Huamarrësi ka të drejtë ta tërheqë nga huaja, do të kryhet ndaj ose me porosi të Huamarrësit.

Seksioni 3.09. E drejta e Huamarrësit për të kryer tërheqje nga huaja do të përfundojë më 31 dhjetor 2020 ose në një datë tjetër, siç mund të bihet herë pas here dakord ndërmjet Huamarrësit dhe Fondit.

Neni IV
Marrëveshje të veçanta

Seksioni 4.01. Huamarrësi do të ndërmarrë masa për të bërë fondet e huas të disponueshme për FSHZH-në nëpërmjet një marrëveshjeje partneriteti ndërmjet Huamarrësit dhe FZHSH-së në formë granti të pranueshëm për Fondin.

Seksioni 4.02. Huamarrësi do të bëjë ose do të marrë masa që të vihen në dispozicion menjëherë, sipas nevojës, të gjitha shumat e tjera që do të kërkohen, përveç huas për realizimin e Projektit, të gjitha shumat e tilla të jenë në dispozicion në kushte në përputhje me detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 4.03. Huamarrësi do të marrë masa që FSHZH-ja t'i japë Fondit, menjëherë pas përgatitjes së tyre, studimet dhe planet dhe specifikimet për Projektin, skicat e ekzekutimit të tij dhe çdo modifikim materiali të bërë më pas atyre, në detaje të tilla që Fondi mund të kërkojë herë pas here.

Seksioni 4.04. Huamarrësi do të marrë masa që FSHZH-ja të realizojë Projektin me kujdesin dhe efikasitetin e duhur dhe në përputhje me praktikat e duhura inxhinierike, administrative dhe financiare.

Seksioni 4.05. Në kryerjen e Projektit, Huamarrësi do të marrë masa që FSHZH-ja të punësojë konsulentë inxhinierikë të pranueshëm për dhe sipas afateve dhe kushteve të kënaqshme për Fondin.

Seksioni 4.06. Dhënia e kontratave për ekzekutimin e Projektit, të cilat duhet të financohen nga huaja dhe çdo ndryshim në to, do të jetë objekt i miratimit të Fondit, si dhe do të kryhet në përputhje me Udhëzimet e Prokurimit të Fondit, përveç metodave të veçanta dhe procedurave të përcaktuara në shtojcën 3 të kësaj Marrëveshjeje dhe duke pasur parasysh kërkesat e shtojcës 4 të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 4.07. Huamarrësi do të marrë masa që FSHZH-ja të mbajë të dhënat e duhura për të identifikuar mallrat e financuara nga fondet e Huas, të bëjë të dukshme përdorimin e tyre në Projekt, për të regjistruar progresin e Projektit (duke përfshirë shpenzimet e tij) dhe të reflektojë në përputhje me praktikat

e qëndrueshme të kontabilitetit të mbajtura në vazhdimësi të operacioneve dhe gjendjen financiare të FSHZH-së. Huamarrësi nëpërmjet FSHZH-së do t'i japë më tej të gjithë mundësinë e arsyeshme përfaqësuesit të akreditуar të Fondit për të kryer vizita për qëllime që lidhen me huan dhe për të inspektuar Projektin, mallrat dhe çdo të dhënë dhe dokumente përkatëse dhe do t'i japë Fondit të gjithë informacionin e tillë që Fondi mund ta kërkojë në mënyrë të arsyeshme në lidhje me shpenzimin e të ardhurave të Huas, Projektin, mallrat dhe operacionet dhe gjendjen financiare të FSHZH-së në lidhje me Projektin.

Huamarrësi do të marrë masa që FSHZH-ja t'i japë Fondit çdo tre muaj, që nga data e fillimit të zbatimit të Projektit, raporte mbi përparimin e zbatimit.

Seksioni 4.08. Huamarrësi do të marrë masa që FSHZH-ja të sigurojë me ofruesit përgjegjës të gjitha furnizimet dhe pajisjet e financuara nga të ardhurat e Huas. Një sigurim i tillë do të mbulojë incidentet detare, të tilla si transiti dhe rreziqe të tjera për blerjen dhe importimin e furnizimeve dhe pajisjeve në territoret e Huamarrësit dhe dorëzimin e tyre në vendin e Projektit dhe do të jetë për shuma të tilla siç duhet të jetë në përputhje me praktikat e qëndrueshme tregtare. Sigurimi i tillë do të jetë i pagueshëm në monedhën në të cilën kostoja e mallrave të siguruara do të paguhet aty ose në monedhë lirisht të konvertueshme.

Huamarrësi do të marrë masa që FZHSH-ja të marrë dhe të ruajë, me ofruesit përgjegjës, sigurimin kundër rreziqeve të lidhura me zbatimin e Projektit, në shuma të tilla që do të jenë në pajtim me praktikat e qëndrueshme tregtare.

Seksioni 4.09. Huamarrësi, nëpërmjet FSHZH-së, do të marrë në kohën e duhur të gjitha veprimet e nevojshme për blerjen e tokës ose të drejtave të tokës të nevojshme për zbatimin e Projektit.

Seksioni 4.10. Huamarrësi dhe Fondi do të bashkëpunojnë plotësisht për të siguruar që të realizohen qëllimet e Huas. Për këtë qëllim, secila palë do t'i japë informacione palës tjetër siç mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme në lidhje me statusin e përgjithshëm të Huas.

Huamarrësi dhe Fondi do të shkëmbejnë herë pas here mendime nëpërmjet përfaqësuesve të tyre për çështjet që lidhen me qëllimet e huas dhe mirëmbajtjen e shërbimit të saj. Huamarrësi, nëpërmjet FSHZH-së, do të informojë menjëherë Fondin për çdo kusht që ndërhyn ose rrezikon të ndërhyjë në arritjen e qëllimeve të huas (duke përfshirë edhe rritje të konsiderueshme në koston e Projektit) apo mirëmbajtjen e shërbimit të tij.

Pas përfundimit të Projektit, Huamarrësi do të marrë masa që FSHZH-ja t'i paraqesë Fondit një Raport Përfundimtar të Projektit jo më vonë se gjashtë muaj pas datës në të cilën e drejta e Huamarrësit për të kryer tërheqje nga huaja përfundon sipas seksionit 3.09 të kësaj Marrëveshje. Raporti i tillë do të jetë në gjuhën angleze dhe përmban një krahasim të shpenzimeve dhe kohëzgjatjen e ekzekutimit të Projektit me shpenzimet dhe kohëzgjatjen e saj të vlerësuar fillimisht. Raporti do të shpjegojë arsyet për ndonjë rritje të ndjeshme të kostos së vlerësuar fillimisht për Projektin apo vonesë në ekzekutimin e tij dhe të tregojë problemet dhe pengesat e hasura dhe masat e marra për trajtimin e tyre.

Seksioni 4.11. Huamarrësi, nëpërmjet FSHZH-së, do të marrë ose të bëjë që të merren të gjitha veprimet e nevojshme nga ana e tij për të ekzekutuar Projektin dhe nuk do të marrë ose nuk të lejojë që të merret ndonjë veprim që do të parandalonte ose ndërhynte në ekzekutimin ose funksionimin e Projektit ose përmbushjen e ndonjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshje.

Seksioni 4.12. Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, do të vazhdojë të mbajë në mënyrë të mjaftueshme dhe të riparojë ose të bëjë të mbahen në mënyrë të mjaftueshme dhe të riparohen rrugët dhe urat e saj në përputhje me standardet e duhura inxhinierike dhe duke i respektuar kërkesat financiare dhe ekonomike dhe duhet të ofrojë menjëherë kur është e nevojshme, fondet, lehtësirat, shërbimet dhe burimet e tjera të nevojshme për këtë qëllim, përfshirë shpërndarjen e mjaftueshme të buxhetit ndaj ARA-s.

Seksioni 4.13. Huamarrësi do të vazhdojë të garantojë që dimensionet dhe ngarkesat e aksit të automjeteve që përdorin rrugët e tij duhet të jenë në përputhje me standardet strukturore dhe gjeometrike të projektimit të këtyre rrugëve. Për këtë qëllim, Huamarrësi do të vazhdojë të mbajë një sistem efikas të kontrollit të ngarkesës së aksit dhe të zbatojë rregullat e përshkruara të ngarkesës boshtore.

Seksioni 4.14. Huamarrësi do të marrë të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e mjedisit dhe për të siguruar që Projekti të realizohet dhe të veprohet në përputhje me praktikat ekologjike dhe mjedisore të përshtatshme për vendin dhe kushtet e tij, të marrë masat e nevojshme për të zbutur ndikimet negative që Projekti mund të ketë në mjedis.

Seksioni 4.15. Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, do të marrë masa që ARSH-ja të veprojë dhe të mirëmbajë Projektin dhe të operojë dhe të mirëmbajë strukturat dhe vepra të

tjera dhe objektet që nuk përfshihen në Projekt, por që janë të nevojshme për funksionimin e tij të duhur dhe efikas në përputhje me praktikat e duhura të inxhinierisë, financiare dhe administrative.

Seksioni 4.16. Huamarrësi do të sigurojë që FSHZH-ja ose çdo organ pasues i pranueshëm për Fondin, të vazhdojë të funksionojë në çdo kohë sipas rregullave dhe rregulloreve dhe të ketë të drejta të tilla menaxhimi dhe administrimi që janë të nevojshme për funksionimin e duhur dhe efikas në realizimin e Projektit.

Huamarrësi, në frymën e bashkëpunimit pozitiv që mbizotëron midis dy palëve, duhet të informojë Fondin për çdo veprim të propozuar që do të ndikonte në natyrën apo përbërjen e FSHZH-së apo çdo organi pasues të pranueshëm për Fondin dhe do t'i japë Fondit të gjithë mundësinë e arsyeshme para marrjes së një veprimi të tillë, për të shkëmbyer mendime me Huamarrësin në lidhje me to.

Seksioni 4.17. Është qëllimi i përbashkët i Huamarrësit dhe i Fondit që asnjë borxh tjetër i jashtëm nuk do të ketë përparësi mbi huan me anë të një barre të krijuar mbi asetet qeveritare. Për këtë qëllim, Huamarrësi merr përsipër që përveç rasteve kur Fondi bie dakord ndryshe, nëse do të krijohet barrë mbi ndonjë aset të Huamarrësit, si garanci për një borxh të jashtëm, një barrë e tillë *ipso facto* do të jetë e barabartë dhe proporcionalisht do të sigurojë pagesën e principalit dhe interesit dhe detyrimet e tjera mbi huan dhe se në krijimin e një barre të tillë, një dispozite e shprehur do të bëhet për këtë qëllim; me kusht që dispozitat e mësipërme të këtij seksioni nuk duhet të zbatohen, për:

i) ndonjë barrë të krijuar mbi pronën, në kohën e blerjes së saj, vetëm si garanci për pagesën e çmimit të blerjes së pronës së tillë;

ii) ndonjë barrë mbi mallrat tregtare për të siguruar një borxh që maturohet jo më shumë se një vit pas datës në të cilën ka lindur fillimisht dhe që duhet të paguhet nga të ardhurat e shitjes së mallrave të tilla komerciale; ose

iii) ndonjë barrë që lind në rrjedhën e zakonshme të transaksioneve bankare dhe sigurimin e borxhit që maturohet jo më shumë se një vit pas datës së tij.

Termi "Asetet e Huamarrësit" siç përdoret në këtë nen përfshin asetet e Huamarrësit ose të ndonjë prej nënndarjeve të tij politike apo ndonjë subjekti në pronësi, apo të kontrolluar nga Huamarrësi ose nga ndonjë nënndarje e tillë politike, duke përfshirë edhe Bankën Qendrore të Huamarrësit ose ndonjë institucion tjetër që kryen funksionet e një Banke Qendrore dhe termi "barrë" përfshin hipotekat, barrët, ngarkesat, privilegjet dhe përparësitë e çdolloji.

Seksioni 4.18. Huamarrësi do të marrë ose do të marrë masa që të merren të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar që FSHZH-ja të vazhdojë të jetë në krye të ekzekutimit dhe të menaxhimit të Projektit dhe do të plotësohet në mënyrë të mjaftueshme nga personel kompetent, duke përfshirë edhe stafin e lartë menaxhues, inxhinierë dhe personel tjetër teknik, si dhe staf të specializuar në financa, prokurim dhe kontabilitet. Për këtë qëllim, Huamarrësi do të sigurojë më tej që FSHZH-ja të realizojë rekrutimin e stafit të duhur, sipas nevojës.

Seksioni 4.19. Principali dhe interesi mbi huan dhe të gjitha detyrimet e tjera do të paguhen pa zbritje dhe pa asnjë tatim në fuqi apo pagesa sipas ligjeve të Huamarrësit apo ligjeve në fuqi në territorin e tij, qoftë aktualisht apo në të ardhmen.

Seksioni 4.20. Kjo Marrëveshje do të jetë e lirë nga çdo taksë, tatim, pagesë, tarifa dhe detyrime të çdo natyre të vendosur sipas ligjeve të Huamarrësit apo ligjeve në fuqi në territorin e tij, qoftë aktualisht apo në të ardhmen, për ose në lidhje me ekzekutimin, lëshimin, ofrimin ose regjistrimin e saj dhe Huamarrësi do të paguajë ose do të marrë masa që të paguhen të gjitha tatimet e tilla, taksat, pagesat dhe detyrimet, nëse ka, të vendosura në bazë të ligjeve të vendit apo vendeve, në monedhën e të cilave mund të shlyhet huaja.

Seksioni 4.21. Principali dhe interesi dhe detyrimet e tjera të huas do të paguhen të lira nga të gjitha kufizimet, duke përfshirë kufizimet e këmbimit të vendosura sipas ligjeve të Huamarrësit apo të ligjeve në fuqi në territorin e tij.

Seksioni 4.22. Të gjitha dokumentet e Fondit, regjistrimet, korrespondenca dhe materiale të ngjashme do të konsiderohen nga Huamarrësi si çështje konfidenciale dhe Huamarrësi do t'i japë Fondit imunitet të plotë nga censura dhe inspektimi i tyre.

Seksioni 4.23. Të gjitha asetet e Fondit dhe të ardhurat do të çlirohen nga shtetëzimi, sekuestrimi dhe konfiskimi.

Neni V
Anulimi dhe pezullimi

Seksioni 5.01. Huamarrësi, duke njoftuar Fondin, mund të anulojë çdo shumë të huas që Huamarrësi

nuk do të ketë tërhequr para dhënies së këtij njoftimi, përveçse Huamarrësi nuk mund të anulojë kështu çdo shumë të huas në lidhje me të cilën Fondi do të ketë hyrë në një angazhim të veçantë në pajtim me seksionin 3.02 të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 5.02. Nëse ndonjë nga ngjarjet e mëposhtme duhet të ketë ndodhur dhe është duke vazhduar, duke njoftuar Huamarrësin Fondi mund të pezullojë tërësisht ose pjesërisht të drejtën e Huamarrësit për të kryer tërheqje nga huaja:

a) Një mosplotësim pagese do të ketë ndodhur në pagesën e principalit ose të interesit ose të ndonjë pagese tjetër të kërkuar sipas kësaj Marrëveshje ose ndonjë marrëveshjeje tjetër huaje ndërmjet Huamarrësit dhe Fondit;

b) Një mospërmbushje do të ketë ndodhur në kryerjen e ndonjë angazhimi ose marrëveshjeje tjetër nga ana e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje;

c) Fondi do të ketë pezulluar tërësisht ose pjesërisht të drejtën e Huamarrësit për të kryer tërheqje në bazë të ndonjë marrëveshjeje tjetër huaje midis Huamarrësit dhe Fondit për shkak të një mospërmbushjeje nga ana e Huamarrësit;

d) Një situatë e jashtëzakonshme do të ketë lindur, e cila do të bëjë të pamundur që Huamarrësi të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje.

Çdo ngjarje që ndodh pas datës së kësaj Marrëveshjeje dhe përpara datës së hyrjes në fuqi, e cila do t'i kishte dhënë të drejtë Fondit për të pezulluar të drejtën e Huamarrësit për të kryer tërheqje, nëse kjo Marrëveshje do të ishte në fuqi në datën kur ka ndodhur një ngjarje e tillë, do t'i japë të drejtë Fondit të pezullojë tërheqjet sipas huas sikur të kishte ndodhur pas datës efektive.

E drejta e Huamarrësit për të kryer tërheqje sipas huas do të vazhdojë të jetë e pezulluar tërësisht ose pjesërisht, sipas rastit, derisa ngjarja ose ngjarjet që kanë çuar në një pezullim të tillë do të kenë pushuar së ekzistuari ose derisa Fondi të ketë njoftuar Huamarrësin se e drejta për të kryer tërheqje është rivendosur; me kusht që, sidoqoftë, në rastin e një njoftimi të tillë të kthimit të së drejtës për të kryer tërheqje do të rivendoset vetëm në masën dhe në bazë të kushteve të specifikuara në këtë njoftim dhe asnjë njoftim i tillë nuk do të ndikojë ose dëmtojë ndonjë të drejtë, kompetencë ose kompensim të Fondit në lidhje me ndonjë ngjarje tjetër të mëvonshme të përshkruar në këtë seksion.

Seksioni 5.03. Nëse ndonjë ngjarje e specifikuar në paragrafin "a" të seksionit 5.02 do të ndodhë dhe do të vazhdojë për një periudhë prej tridhjetë ditësh pas njoftimit të dhënë nga Fondi për Huamarrësin ose në qoftë se ndonjë ngjarje e specifikuar në paragrafët "b", "c" dhe "d" të seksionit 5.02 do të ndodhë dhe do të vazhdojë për një periudhë prej gjashtëdhjetë ditësh pas njoftimit, dhënë nga Fondi për Huamarrësin, atëherë në çdo kohë të mëvonshme gjatë vazhdimit të saj, Fondi, në zgjedhjen e tij, mund të deklarojë principalin e huas të kërkueshëm dhe të pagueshëm menjëherë dhe pas çdo deklarate të tillë, principali do të bëhet i pagueshëm menjëherë, pavarësisht ndonjë elementi të kundërt në këtë Marrëveshje.

Seksioni 5.04. Nëse: a) e drejta e Huamarrësit për të kryer tërheqje nga huaja do të jetë pezulluar në lidhje me ndonjë shumë të huas për një periudhë të vazhdueshme prej tridhjetë ditësh; ose b) në datën e specifikuar në seksionin 3.09 si data e mbylljes, një shumë e huas do të mbetet e patërhequr, Fondi, duke njoftuar Huamarrësin mund të ndërpresë të drejtën e Huamarrësit për të kryer tërheqje në lidhje me këtë shumë. Pas dhënies së këtij njoftimi kjo shumë e huas do të anulohet.

Seksioni 5.05. Asnjë anulim ose pezullim nga Fondi nuk do të zbatohet për shumat që i nënshtrohen ndonjë angazhimi të veçantë të parevokueshëm të lidhur nga Fondi në pajtim me seksionin 3.02, përveç kur parashikohet shprehimisht në angazhimin e tillë.

Seksioni 5.06. Përveç rasteve kur Fondi mund të bjerë dakord ndryshe, çdo anulim do të zbatohet proporcionalisht në disa këste të principalit kryesor të huas së maturuar pas datës së një anulimi të tillë.

Seksioni 5.07. Pavarësisht nga çdo anulim ose pezullim, të gjitha dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të vazhdojnë të jenë në fuqi dhe efekt të plotë, përveç kur parashikohet në mënyrë specifike në këtë seksion.

Neni VI
Zbatueshmëria e kësaj Marrëveshjeje; mosushtrimi i të drejtave; arbitrazhi

Seksioni 6.01. Të drejtat dhe detyrimet e Fondit dhe Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje do të jenë të vlefshme dhe të zbatueshme në pajtim me kushtet e tyre, pavarësisht ndonjë ligji vendës për të kundërtën. As Huamarrësi dhe as Fondi nuk kanë të drejtë në asnjë rrethanë të pohojnë ndonjë pretendim që ndonjë dispozitë e kësaj Marrëveshje është e pavlefshme ose e pazbatueshme për çfarëdo arsye.

Seksioni 6.02. Asnjë vonesë në ushtrimin ose mosveprimin për të ushtruar ndonjë të drejtë, kompetencë

apo zgjidhje ligjore që rrjedh për të dyja palët sipas kësaj Marrëveshje për çdo mospërmbushje, nuk do të pengojë atë të drejtë, kompetencë ose mjet të tillë ose nuk do të interpretohet si heqje dorë prej saj, ose pranim i heshtur i një mospërmbushjeje të tillë dhe as veprimi i asaj pale në lidhje me çdo mospërmbushje apo pranim të heshtur në çdo mospërmbushje, nuk do të ndikojë ose dëmtojë ndonjë të drejtë, kompetencë ose zgjidhje të kësaj pale në lidhje me ndonjë mospërmbushje tjetër ose vijuese.

Seksioni 6.03. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të kësaj Marrëveshjeje dhe çdo pretendim nga secila palë kundër tjetrës që rrjedh nga kjo Marrëveshje do të zgjidhet me marrëveshje të palëve dhe me dështimin e një marrëveshjeje të tillë, konflikti ose pretendimi do të paraqitet në arbitrazh nga një Gjykatë Arbitrazhi, siç parashikohet në seksionin në vijim.

Seksioni 6.04. Gjykata e Arbitrazhit do të përbëhet nga tre arbitra të caktuar si vijon: një arbitër do të caktohet nga Huamarrësi; arbitri i dytë do të caktohet nga Fondi; dhe arbitri i tretë (në tekstin në vijim i referuar ndonjëherë si Arbitri) do të caktohet me marrëveshje të palëve. Në rast se ndonjë arbitër i emëruar në përputhje me këtë seksion do të japë dorëheqjen, vdes ose bëhet i paaftë për të vepruar, një arbitër pasardhës do të emërohet në të njëjtën mënyrë të përshkruar më parë për emërimin e arbitrit fillestar dhe pasardhësi i tillë do të ketë të gjitha kompetencat dhe detyrat e këtij arbitri fillestar.

Procedimet e arbitrazhit mund të kenë lindur në bazë të këtij seksioni pas njoftimit nga njëra palë për tjetrën. Ky njoftim duhet të përmbajë një deklaratë që përcakton natyrën e debatit ose të pretendimit që do të paraqitet për arbitrazh, natyrën dhe shtrirjen e zgjidhjes së kërkuar dhe emrin e arbitrit të emëruar nga pala që fillon këto procedura.

Brenda tridhjetë ditëve pas dhënies së këtij njoftimi, pala tjetër do ta njoftojë palën që fillon procedurat për emrin e arbitrit të caktuar nga pala tjetër dhe në pamundësi të kësaj, një arbitër i tillë do të caktohet nga Kryetari i Gjykatës Ndër-kombëtare të Drejtësisë me kërkesën e palës që fillon procedimet.

Nëse brenda gjashtëdhjetë ditëve pas dhënies së njoftimit për hapjen e procedurave të arbitrazhit, palët nuk kanë rënë dakord për Arbitrin, secila palë mund t'i kërkojë Kryetarit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për të emëruar një Arbitër.

Gjykata e Arbitrazhit do të mblidhet për herë të parë në kohën dhe vendin që është përcaktuar nga Arbitri. Pas kësaj, Gjykata e Arbitrazhit do të vendosë se ku dhe kur do të mblidhet.

Në bazë të dispozitave të këtij seksioni dhe përveç rasteve kur Palët bien dakord ndryshe, Gjykata e Arbitrazhit do të vendosë të gjitha çështjet në lidhje me kompetencën e saj dhe do të përcaktojë procedurën e saj në mënyrë që të përballojë një dëgjim të drejtë për çdo palë dhe do të përcaktojë çështjet e paraqitura në të, qoftë nëse të dyja palët paraqiten para saj ose në mungesë të paraqitjes së njërës prej tyre. Vendimet e Gjykatës së Arbitrazhit do të jenë me shumicën e votave dhe ajo do ta japë vendimin e saj me shkrim. Dhënia e tillë do të nënshkruhet të paktën nga shumica e anëtarëve të Gjykatës së Arbitrazhit dhe një kopje e nënshkruar e saj do t'i transmetohet çdo pale. Vendimi i Gjykatës së Arbitrazhit i dhënë në pajtim me dispozitat e këtij seksioni do të jetë përfundimtar dhe detyrues për palët që duhet t'i përmbahen dhe të jenë në përputhje me dhënien e tillë.

Palët do të caktojnë shumën e shpërblimit apo tarifat e arbitrave dhe të personave të tjerë siç do të kërkohet për kryerjen e procedurave të arbitrazhit. Nëse palët nuk bien dakord për një shumë të tillë para se Gjykata e Arbitrazhit të mblidhet, Gjykata e Arbitrazhit do të caktojë një shumë të tillë që do të jetë e arsyeshme sipas rrethanave. Çdo palë do të mbulojë shpenzimet e veta në procedurat e arbitrazhit. Shpenzimet e Gjykatës së Arbitrazhit do të ndahen ndërmjet dhe do të përballohen në mënyrë të barabartë nga palët. Çdo çështje në lidhje me ndarjen e shpenzimeve të Gjykatës së Arbitrazhit ose procedura për pagesën e shpenzimeve të tilla do të përcaktohet nga Gjykata e Arbitrazhit.

Gjykata e Arbitrazhit do të zbatojë parimet e përbashkëta sipas ligjeve aktuale të Huamarrësit dhe shtetit të Kuvajtit, si dhe parimet e drejtësisë.

Seksioni 6.05. Dispozitat për arbitrazhin e përcaktuara në seksionin e mëparshëm do të jenë në vend të çdo procedure tjetër për përcaktimin e mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve të kësaj Marrë-veshjeje dhe çdo pretendim nga secila palë ndaj palës tjetër që rrjedh prej saj.

Seksioni 6.06. Dërgimi i çdo njoftimi ose kryerja e procesit në lidhje me procedurat në bazë të këtij neni, mund të kryhet në mënyrën e parashikuar në seksionin 7.01. Palët e kësaj Marrëveshjeje mund të heqin dorë nga të gjitha kërkesat e tjera për dërgimin e ndonjë njoftimi apo kryerjen e një procesi të tillë.

Neni VII
Dispozita të ndryshme

Seksioni 7.01. Çdo njoftim ose kërkesë që kërkohet ose lejohet të jepet ose bëhet sipas kësaj Marrëveshjeje do të jetë me shkrim. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në seksionin 8.03, njoftimi apo kërkesa e tillë do të konsiderohet se është dhënë ose bërë rregullisht, nëse dërgohet dorazi ose me postë ose faks për palën për të cilën kërkohet ose lejohet të jepet ose bëhet në adresën e tillë të palës të specifikuar në këtë Marrëveshje ose në një adresë tjetër që një palë e tillë do të ketë caktuar me anë të njoftimit për palën tjetër, duke dhënë këtë njoftim ose duke bërë një kërkesë të tillë.

Seksioni 7.02. Huamarrësi do t'i japë Fondit prova të mjaftueshme të autoritetit të personit ose personave që do të nënshkruajnë aplikimet e parashikuara në nenin III ose që, në emër të Huamarrësit, do të marrë ndonjë veprim tjetër apo do të nënshkruajë ndonjë dokument tjetër të nevojshëm ose që lejohet të merret ose nënshkruhet nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje dhe modelin e vërtetuar të nënshkrimit të çdo personi të tillë.

Seksioni 7.03. Çdo veprim që kërkohet ose lejohet që të merret dhe të gjitha dokumentet që kërkohen ose lejohen për t'u nënshkruar sipas kësaj Marrëveshjeje në emër të Huamarrësit mund të merren ose nënshkruhen nga ministri i Financave të Huamarrësit ose çdo person i autorizuar me shkrim prej tij. Çdo modifikim ose zgjerim i dispozitave të kësaj Marrëveshjeje mund të bihet dakord në emër të Huamarrësit me dokument të shkruar të ekzekutuar në emër të Huamarrësit nga përfaqësuesi i tij i sipërpërmendur, me kusht që sipas mendimit të përfaqësuesit, një ndryshim apo përforcim i tillë të jetë i arsyeshëm sipas rrethanave dhe nuk do të rrisë ndjeshëm detyrimet e Huamarrësit, sipas kësaj Marrëveshjeje. Fondi mund të pranojë nënshkrimin me përfaqësues të tillë apo person tjetër të ndonjë dokumenti të tillë si dëshmi bindëse se sipas opinionit të këtij përfaqësuesi, çdo modifikim ose zgjerim i dispozitave të kësaj Marrëveshjeje i kryer nga një instrument i tillë është i arsyeshëm sipas rrethanave dhe nuk do të rrisë ndjeshëm detyrimet e Huamarrësit.

Neni VIII
Hyrja në fuqi; përfundimi

Seksioni 8.01. Kjo Marrëveshje nuk hyn në fuqi derisa Fondit t'i jenë dhënë prova të kënaqshme që nënshkrimi dhe dorëzimi i kësaj Marrëveshjeje në emër të Huamarrësit është autorizuar nga të gjitha veprimet e nevojshme qeveritare.

Seksioni 8.02. Si pjesë e provave që do të dërgohen në pajtim me seksionin 8.01, Huamarrësi do t'i japë Fondit një opinion ose opinione të lëshuar/a nga ministri i Drejtësisë që tregojnë se kjo Marrëveshje është autorizuar ose ratifikuar ligjërisht dhe nënshkruar dhe dorëzuar në emër të Huamarrësit dhe përbën një detyrim të vlefshëm dhe detyrues për Huamarrësin në përputhje me kushtet e saj.

Seksioni 8.03. Përveç rasteve kur bihet dakord ndryshe nga Fondi dhe Huamarrësi, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën kur Fondi i dërgon me postë apo faks Huamarrësit njoftim për pranimin e provave të kërkuara nga seksioni 8.01.

Seksioni 8.04. Nëse të gjitha aktet e nevojshme që duhet të kryhen në pajtim me seksionin 8.01 nuk do të jenë kryer para (150) ditëve pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje ose në ndonjë datë tjetër që do të bihet dakord nga Fondi dhe Huamarrësi, Fondi në çdo kohë pas kësaj, në gjykimin e tij mund të përfundojë këtë Marrëveshje duke njoftuar Huamarrësin. Pas dhënies së këtij njoftimi, kjo Marrëveshje dhe të gjitha detyrimet e palëve sipas saj do të përfundojnë menjëherë.

Seksioni 8.05. Nëse dhe kur e gjithë shuma e principalit të huas dhe i gjithë interesi dhe detyrimet e tjera, të cilat do të jenë llogaritur mbi huan do të jenë paguar, kjo Marrëveshje dhe të gjitha detyrimet e palëve sipas saj, do të përfundojnë menjëherë.

Neni IX
Përkufizimet

Seksioni 9.01. Përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime, kudo që përdoren në këtë Marrëveshje ose çdo shtojcë të saj:

1. Termi "Projekt" do të thotë projekti për të cilin është dhënë huaja, siç përshkruhet në shtojcën 2 të kësaj Marrëveshjeje dhe siç përshkrimi i tij do të ndryshohet nëse është i nevojshëm me marrëveshje ndërmjet Fondit dhe Huamarrësit.

2. Termi "Mallra" nënkupton pajisjet, furnizimet, shërbimet dhe punët që kërkohen për Projektin. Kudo që i bëhet referencë kostos së çdo malli, një kosto e tillë do të konsiderohet të përfshijë koston e importimit

të mallrave të tilla në territorin e Huamarrësit.

3. Termi "FSHZH" do të thotë Fondi Shqiptar i Zhvillimit, i cili rregullohet me ligjin nr. 10 130, të datës 11.5.2009.

4. Termi "Marrëveshje partneriteti" nënkupton marrëveshjen ndërmjet Ministrisë së Financave dhe FSHZH-së, për të bërë të ardhurat e huas të disponueshme për FSHZH-në, në formë granti dhe në terma dhe kushte të kënaqshëm për Fondin.

5. Termi "ARSH" do të thotë Autoriteti Rrugor Shqiptar, i cili rregullohet me ligjin nr. 10 164, datë 15.10.2009.

6. Udhëzimet e Prokurimeve të Fondit të Kuvajtit do të thotë Udhëzuesi për Prokurimin e Mallrave dhe Kontraktimi për Kryerjen e Punimeve – Botimi 2001.

Adresat e mëposhtme janë specifikuar për qëllimet e seksionit 7.01:

Për Huamarrësin:
Ministria e Financave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3
Tiranë, Shqipëri
Adresa alternative për fakset dhe postën elektronike:

FAKS	E-MAIL
+35542228494	sekretariamin@financa.gov.al

Për Fondin:
Fondi Kuvajtian për Zhvillimin Ekonomik Arab
Kutia Postare 2921, Safat
Kuvajt - 13030

Adresa alternative për fakset dhe postën elektronike:

FAKS	E-MAIL
(965) 22999190	operations@kuwait-fund.org
(965) 22999091	

Në dëshmi sa më sipër, palët, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar ligjërisht, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje në emrat e tyre përkatës dhe kanë dorëzuar në Tiranë, në dy kopje, secila e konsideruar si origjinale dhe të dyja për të njëjtin efekt, si në ditën dhe vitin e shkruar më lart.

Republika e Shqipërisë
Nga:.....
(përfaqësuesi i autorizuar)
Fondi Kuvajtian për
Zhvillimin Ekonomik Arab
Nga:.....
(përfaqësuesi i autorizuar)

SHTOJCA 1
DISPOZITAT E SHLYERJES

Shuma e principalit e tërhequr nga huaja do të paguhet në 38 këste gjashtëmujore, shuma dhe renditja e secilit, siç përcaktohet në tabelën bashkëlidhur. I pari prej këtyre kësteve do të jetë i pagueshëm në datën e parë në të cilën çdo interes apo pagesat e tjera të kredisë do të bëhen të pagueshme, në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së Huas, pas kalimit të një periudhe pa pagesë principali prej 5 vitesh, duke filluar nga data në të cilën Fondi paguan ndonjë shumë nga huaja sipas aplikimit të parë për tërheqje të kryer nga Huamarrësi ose nga data kur Fondi lëshon një sipërmarrje në pajtim me seksionin 3.02 të Marrëveshjes së Huas, në rast se aplikimi i tërheqjes së parë kërkon lëshimin e një sipërmarrjeje të tillë, cilado që është më herët nga dy datat. Kështet e mbetura për shlyerjen e principalit do të jenë të njëpasnjëshme, çdo gjashtë muaj, pas datës në të cilën duhet të paguhet kësti i parë.

SKEDULI PËR SHTOJCËN 1
SKEDULI I AMORTIZIMIT

Nr.	Data e pagesës përkatëse	Pagesa e principalit (shprehur në dinarë kuvajtianë)
1		315,700
2		315,700
3		315,700
4		315,700
5		315,700
6		315,700
7		315,700
8		315,700
9		315,700
10		315,700
11		315,700
12		315,700
13		315,700
14		315,700
15		315,700
16		315,700
17		315,700
18		315,700
19		315,700
20		315,700
21		315,700
22		315,700
23		315,700
24		315,700
25		315,700
26		315,700
27		315,700
28		315,700
29		315,700
30		315,700
31		315,700
32		315,700
33		315,700
34		315,700
35		315,700
36		315,700
37		317,400
38		317,400
	TOTALI	**12,000,000**
(Dymbëdhjetë milionë dinarë kuvajtianë)		

SHTOJCA 2
PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Projekti do të kontribuojë në drejtim të zhvillimit ekonomik dhe social të rajonit të Vlorës, nëpërmjet përmirësimit të shërbimit të transportit të udhëtarëve dhe mallrave që do të reduktojë kohën e udhëtimit dhe minimizojë koston e transportit, përveç ofrimit të sigurisë në trafik. Projekti përfshin punimet civile për rishtrimin e rrugës kryesore ekzistuese 74 km Vlorë–Peshkepi–Qeparo dhe zgjerimin e saj në një rrugë me dy drejtime me 3.75 m gjerësi dhe 0.75 m anë xhadeje për çdo rrugë. Projekti përfshin edhe vepra të rehabilitimit për strukturat e kullimit, të sigurisë dhe të ndriçimit përveç vendkalimit të këmbësorëve që përshkojnë qytetet kryesore përgjatë rrugës, si dhe ofrimin e shërbimeve të nevojshme të konsulencës për skicim, dokumentet e tenderit, të projektit dhe mbikëqyrjen e punimeve.

Projekti përfshin komponentët kryesorë të mëposhtëm:

1. Përgatitja e punimeve në vendin e punës.
2. Shtrimi i sipërfaqes.
3. Rehabilitimi i kullimit, siguria dhe ndriçimi, duke përfshirë edhe veprat e ndryshme.
4. Shërbime konsulence në lidhje me inxhinierinë.

Projekti pritet të fillojë në fillim të vitit 2016 dhe të përfundojë në fund të vitit 2019.

SHTOJCA 3
LISTA E MALLRAVE QË DO TË FINANCOHEN NGA HUAJA DHE METODAT DHE PROCEDURAT PËR PROKURIM

1. Artikujt që do të financohen nga huaja dhe shpërndarja për çdo njësi dhe përqindja e shpenzimeve që do të financohen në këtë mënyrë caktohen si në "Listën e mallrave" bashkëlidhur. Është rënë dakord në këtë mënyrë ndërmjet Huamarrësit dhe Fondit, se nëse të dyja palët zbulojnë se shpërndarja për çdo njësi është e pamjaftueshme për të financuar përqindjen e përcaktuar në listën e përmendur të mallrave të kostos së pritshme të kësaj njësie, ata mund të marrin ndonjë nga këto masa:

a) të alokojnë për atë njësi, brenda kufirit të shumës së nevojshme për të mbuluar mungesën në financim në bazë të përqindjes së caktuar, një shumë shtesë kundrejt fondit të alokuar për zëra të paparashikuar në "Listën e mallrave" apo kundrejt shpërndarjes për çdo njësi tjetër ku ka tepricë në atë shpërndarje.

b) të zvogëlojë përqindjen që do të financohet nga huaja të kostos së përgjithshme të njësisë të caktuar, nëse shpërndarja shtesë për atë njësi, në përputhje me sa më sipër, është e pamjaftueshme për të mbuluar mungesën e përmendur më sipër ose nëse të dyja palët janë të mendimit se nuk është e mundur që të alokohet ndonjë shumë shtesë prej huas për këtë njësi, në mënyrë që si pasojë e një zvogëlimi të tillë, tërheqje nga huaja do të vazhdojnë për financimin e kostos së mallrave, punimeve ose shërbimeve të përfshira në këtë njësi derisa kostoja e tyre totale të jetë mbuluar plotësisht.

2. Huamarrësi bie dakord që të ardhurat e huas nuk do të përdoren për pagimin e çfarëdo takse apo detyrimi të vendosur sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

3. Huamarrësi, gjithashtu, bie dakord që të gjitha njësitë që do të financohen nga huaja do të grupohen në paketa të përshtatshme nga pikëpamja e llojit dhe madhësisë, me qëllim që të lehtësojnë, në masën e mundshme, marrjen e ofertave të tenderit të hapur ndërkombëtar (ICB). Përveç kur këtu është shprehur ndryshe ose bihet dakord me Fondin, procedura e tenderimit konkurrues ndërkombëtar do të përdoret për prokurimin e të gjitha njësive të tilla.

4. Në lidhje me shërbimet e konsulencës të kërkuara për punimet, këto shërbime do të prokurohen në përputhje me Udhëzimet e Fondit për Përdorimin e Konsulentëve, si dhe procedurat e deklaruara në këtë shtojcë. Një listë e përzgjedhur e të paktën 6 (gjashtë) konsulentëve kuvajtianë dhe një numër i ngjashëm i konsulentëve lokalë do të përgatitet në marrëveshje me Fondin dhe konsulentët në listën e përzgjedhur do të ftohen për të paraqitur propozimet e tyre. Konsulenti kuvajtian dhe shqiptar do të ftohen të dorëzojnë ofertat e tyre në bashkëpunim me njëri-tjetrin, d.m.th. bashkërisht ose secili veçmas. Për qëllim të kërkesave të mësipërme, një konsulent nuk do të konsiderohet si kuvajtian apo shqiptar, përveç kur firma e tij është e bazuar në secilin vend dhe në pronësi me një masë prej jo më pak se 51% nga shtetas të Kuvajtit ose Shqipërisë. Ftesa e propozimeve do të bëhet në bazë të termave të referencës të rënë dakord me Fondin dhe letra e ftesës do të kërkojë dorëzimin e propozimeve teknike dhe financiare në zarfe të veçanta. Propozimet teknike do të hapen më parë dhe vlerësohen dhe më pas propozimet financiare duhet të hapen dhe do të kryhet një vlerësim i kombinuar teknik dhe financiar. Vlerësimi në çdo fazë do të kryhet në përputhje me kriteret e miratuara me Fondin paraprakisht dhe të përcaktuara në ftesën e propozimeve.

5. Tenderët për ndërtimin e veprave do të prokurohen në bazë të ofertave ndërkombëtare konkurruese (ICB). Njoftimi i ftesës për kontraktuesit e interesuar që të paraqesin ofertat e tyre do të botohet në të paktën një gazetë periodike ndërkombëtare, dy gazeta të përditshme kuvajtiane dhe të paktën në një gazetë lokale. Pas marrjes së ofertave, një raport për vlerësimin teknik dhe financiar të ofertave duhet të përgatitet dhe të dorëzohet te Fondi për shqyrtim dhe miratim nga Fondi, së bashku me rekomandimin për dhënien. Në rast se është e nevojshme për të kryer bisedime me ofertuesin e zgjedhur, drafti i kontratës përfundimtare që del nga këto bisedime do t'i dërgohet Fondit për miratim.

6. Për sa i përket zbatimit të seksionit 4.06 të Marrëveshjes së huas dhe prokurimit të të gjitha njësive të mallrave dhe punimeve që do të financohen nga huaja, procedura për të ftuar ofertat, si dhe draftdokumentet për tenderin për prokurimin e këtyre mallrave dhe punimeve do t'i vihen në dispozicion Fondit për shqyrtim dhe miratim dhe do të kryhen ndryshimet e arsyeshme që mund të kërkohen nga Fondi

në dokumente të tilla ose në procedurat e tenderimit.

7. Pas nënshkrimit të çfarëdo kontrate që do të financohet nga huaja, një origjinal ose kopje e konfirmuar dhe e vërtetuar e kontratës do t'i dërgohet Fondit për të dhënat e tij dhe për qëllimin e disbursimeve nga huaja. Çdo ndryshim material i propozuar për t'u bërë në ndonjë kontratë do të paraqitet pranë Fondit për miratim.

LISTA E MALLRAVE

SI. Nr.	**Njësia**	**Shpërndarja e të ardhurave (dinarë kuvajtianë)**	**Përqindja ndaj kostos totale të njësisë**
1	Ndërtimi i punimeve civile	9,913,000	77%
2	Shërbimet e konsulencës	777,000	100%
3	Zërat e paparashikuar të pashpërndarë	1,310,000	
	TOTALI	**12,000,000 (Dymbëdhjetë milionë dinarë kuvajtianë)**	

SHTOJCA 4

Huamarrësi pranon se ai ka qenë i informuar siç duhet që në përputhje me rregullat në fuqi në shtetin e Kuvajtit, përdorimi i fondeve publike në lidhje me transaksionet që përfshijnë ndonjë firmë apo shoqëri që i nënshtrohet bojkotit sipas këtyre rregullave, është i ndaluar.

Huamarrësi, pra, merr përsipër që të ardhurat e huas nuk do të përdoren në asnjë mënyrë për të financuar drejtpërdrejt ose tërthorazi çfarëdo mallrash apo shërbimesh të prodhuara apo të furnizuara nga ndonjë vend, firmë apo subjekt që i nënshtrohet bojkotit sipas rregullave në fuqi në shtetin e Kuvajtit.